



SQ

Shenjat e gishtave dhe Eurodac

Informacion për shtetasit e vendeve të treta ose
përsnat pa shtetësi të gjetur që rrinë në mënyrë të
paligjshme në një shtet anëtar, sipas nenit 29(3)
të rregullores së (BE) nr. 603/2013

Nëse ju gjendeni që rrini në mënyrë të paligjshme në një vend të 'Dublinit'⁽¹⁾, autoritetet mund t'ju marrin shenjat tuaja të gishtave dhe t'i transmetojnë ato në një bazë të dhënash për shenjat e gishtave të quajtur "Eurodac". Kjo është vetëm me qëllim për të parë nëse ju keni aplikuar më parë për azil. Të dhënat tuaja të shenjave të gishtave nuk do të ruhen në bazën e të dhënave të Eurodac, por nëse ju keni aplikuar më parë për azil në një vend tjetër, ju mund të dërgoheni mbrapsht në atë vend.

Nëse shenjat tuaja të gishtave nuk janë të një cilësie të qartë, përfshirë nëse ju me dashje i keni dëmtuar gishtat, shenjat e gishtave mund t'ju merren përsëri në të ardhmen.

Eurodac operohet nga një Agjensi e Bashkimit Europian e quajtur eu-LISA. Të dhënat tuaja mund të përdoren vetëm për qëllime të identifikuara nga ligji. Vetëm Sistemi Qendror i Eurodac do të marrë të dhënat tuaja. Nëse ju kërkon azil në të ardhmen në një vend tjetër të Dublinit, shenjat tuaja të gishtave gjithashtu do të merren për t'u transmetuar në Eurodac. Të dhënat e ruajtura në Eurodac nuk do të ndahen me asnjë vend ose organizatë tjetër jashtë BE dhe vendeve të asociuara.

- 1) **Shtrihet në të gjithë Bashkimin Europian (Austrinë, Belgjikën, Bullgarinë, Kroacinë, Qipron, Republikën Çeke, Danimarkën, Estoninë, Finlandën, Francën, Gjermaninë, Greqinë, Hungarinë, Irlandën, Italinë, Letoninë, Lituanië, Luksemburgun, Maltën, Hollandën, Poloninë, Portugalinë, Rumannë, Sllovakinë, Slloveninë, Spanjë, Sëedinë) si dhe 4 vendet "e asociuara" me Rregullin e Dublinit (Norvegjinë, Islandën, Zvicrën dhe Litenshteinin).**

©Bashkimi Europian 2014

Autorizohet riprodhimi. Për çdo përdorim ose ri-prodhim të fotove individuale leja duhet kërkuar direkt nga mbajtësit e të drejtës së autorit.

Informacioni Kontakti

Mbajtësi i regjistrimit të Eurodacit dhe përfaqësuesi i tij

Punktet e përbashkëta:
Administrata e policisë
(Poliisihallitus) dhe Zyra e Migracionit (Maahanmuuttovirasto)

Të dhënat për kontakt të zyrës së mbajtësit të regjistrimit

Poliisihallitus
(Administrata e policisë)
PL 1000 (Vuorimiehentie 3),
02151 Espoo
+358 295 480 181
kirjaamo.poliisihallitus@poliisi.fi

Maahanmuuttovirasto
(Zyra e Migracionit)
PL 10, 00086 Maahanmuuttovirasto
Tel. +358 295 430 431 (centrali)
migri@migri.fi www.migri.fi

Nëse dëshiron të njoftohesh me të dhënat që janë regjistruar për ty në sistemin Eurodac, parashtro një kërkesë personalisht në polici.

Nëse autoritetet tona konsiderojnë se ju mund të keni aplikuar për mbrojtje ndërkombëtare në një vend i cili mund të jetë përgjegjës për shqyrtimin e atij aplikimi, ju do të merrni informacion më të detajuar rreth procedurës që do të ndiqet dhe sesi ajo ju ndikon ju dhe të drejtat tuaja.

Përgatitu të dëshmosh identitetin. Rekomandojmë që të kontaktosh zyrën policore, e cila pranoi aplikimin tënd për azil. Të dhënat për kontakt: www.poliisi.fi.

Të dhënat për kontakt të autoritetit zyrtar kombëtar për mbrojtjen e të dhënave

Tietosuojaaltuutetus toimisto
(Zyra e ombudsmanit për mbrojtjen e të dhënave)
Adresa rrugore:
Lintulahdenkuja 4, 00530 Helsinki
Adresa postare:
PL 800, 00531 Helsinki
Centrali telefonik:
+358 29 566 6700
Këshillimi i përgjithshëm telefonik për persona privat:
+358 29 566 6777
e martë – e enjte ora 9.00–11.00
tietosuoja@om.fi
www.tietosuoja.fi





Rajavartiolaitos
Gränsbevakningsväsendet
The Finnish Border Guard